

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data : 24.09.2018]

Për: Bashkimin e Operatoreve Ekonomike "Albstar" shpk (80%) & "Hastoci" shpk (20%), perfaqesuar nga shoqeria "Albstar" shpk, me adrese: Zona Industriale, Patos, Fier, me NIPT J62903512W.

Procedura e prokurimit: **"Tender i Hapur"** me objekt : **"Rehabilitim i Lumit Gjanica dhe Rikonceptim i Qendres se qytetit te Fierit"**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **"Rehabilitim i Lumit Gjanica dhe Rikonceptim i Qendres se qytetit te Fierit"**.

Numri i referencës së procedurës: **REF-74756-06-13-2018.**

Kohëzgjatja: brënda 18 muaj nga data e fillimit te punimeve.

Fondi limit: 708.127.500 (shtatëqind e tetë milion e njëqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind) lekë pa tvsh. Fondi i akorduar për vitin 2018 është 143.936.828 lekë pa tvsh. Pjesa e mbetur është parashikuar për vitin 2019.

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Datë 06.08.2018.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Nuk ka patur.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

NR	SHOQERIA	NIPTI	OFERTA PA TVSH PARA KONTROLLIT ARITMETIK
1	"VICTORIA INVEST" SHPK (38%)	K32712206U	600,240,637
	"VICTORIA INVEST INTERNATIONAL" SHPK (41%)	L02712202J	
	"AL ASFALT" SHPK (21%)	K81511508A	
2	"CURRI" SHPK	J67902718S	605,340,027
3	"GJOKA KONSTRUKSION" SHPK	J91815014U	633,929,382
4	"ALBSTAR" SHPK (80%)	J62903512W	676,303,207
	"HASTOCI" SHPK (20%)	J62028009B	
5	"VIANTE KONSTRUKSION" SHPK	K47103804L	705,120,870
6	"GPG" SHPK	J64324443V	708,005,438
7	"GRAND KONSTRUKSION M" SHPK		NUK KA PARAQITUR DOKUMENTACION
8	"KAJMAKU" SHPK		NUK KA PARAQITUR DOKUMENTACION
9	"VELLEZERIT HYSA" SHPK		NUK KA PARAQITUR DOKUMENTACION

Pas vleresimit te dokumentacionit te paraqitur komisioni me unanimitet vendosi:

Te skualifikoje bashkimin e Operatoreve Ekonomike "Victoria Invest" shpk (38%), "Victoria Invest international" shpk (41%) dhe "Al Asfalt" shpk (21%) pasi:

Shoqeria "Victoria Invest International" shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.7 per kualifikim lidhur me disponimin e pikave te nevojshme te licenses, pasi, referuar marreveshjes se bashkepunimit, ka marre persiper 100% te punimeve ne shtratin e lumit dhe nuk disponon piken e kerkuar te licenses NS 15 D. Kjo shoqeri disponon piken e licenses NS 15 A e cila eshte e pamjaftueshme per volumin e puneve qe do te kryhen.

Shoqeria "Al Asfalt" shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.2 per kualifikim lidhur me numrin e nevojshem te punonjesve, pasi sipas perqindjes se punes qe ka marre persiper duhet te angazhoje ne pune 36 punonjes, nderkohe qe per periudhen e kerkuar ka te punesuar rreth 89 punonjes nga te cilet 81 jane te angazhuar ne kontraten me objekt "Rruga qender Gose – hekurudha - Gose e madhe, bashkia Rrogozhinë" lidhur ndermjet shoqerise "Al Asfalt" shpk dhe Fondit Shqiptar te Zhvillimit ne daten 23.08.2018.

Shoqeria "Al Asfalt" shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.4 per kualifikim lidhur me stafin drejtues, pasi inxhinieret Adnan Kopliku (inxhinier ndertimi), Dritan Hoxha (inxhinier ndertimi), Robert Sako (inxhinier hidroteknik), Ferdinand Tola (inxhinier gjeodet) dhe Lindita Diko (inxhinier elektrike) jane te angazhuar ne kontraten me objekt "Rruga qender Gose – hekurudha - Gose e madhe, bashkia

Rrogozhinë” lidhur ndermjet shoqerise “Al Asfalt” shpk dhe Fondit Shqiptar te Zhvillimit ne daten 23.08.2018.

Shoqeria “Al Asfalt” shpk nuk ploteson kerkesen 2.3.8 per kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve dhe paisjeve, pasi nga mjetet e deklaruar vetem mjeti furce mekanike, skelerite dhe impainti i betonit jane te pa angazhuar. Te gjitha mjetet e tjere jane te angazhuar ne kontraten me objekt “Rruga qender Gose – hekurudha - Gose e madhe, bashkia Rrogozhinë” lidhur ndermjet shoqerise “Al Asfalt” shpk dhe Fondit Shqiptar te Zhvillimit ne daten 23.08.2018.

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete bashkim shoqerish.

Te skualifikoje Operatorin Ekonomik “Curri” shpk pasi:

Nuk ploteson kerkesen 2.2.3 per kualifikim lidhur me detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, pasi nuk ka paraqitur mandat pagesat per shlyerjen e detyrimeve vendore ne Elbasan, Vau i Dejes, Vlore, Malesi e Madhe, Divjake, Shkoder, Korce, Bulqize, Kruje.

Nuk ploteson kerkesen 2.3.7 per kualifikim lidhur me disponimin e pikave te nevojshme te licenses, pasi nuk disponon piken e kerkuar te licenses NS 15 D. Kjo shoqeri disponon piken e licenses NS 15 A e cila eshte e pamjaftueshme per volumin e puneve qe do te kryhen. Shoqeria “Curri” shpk nuk ka paraqitur grafikun e detajuar te punimeve duke parashikuar vleren e plote te punimeve pa tvsh per cdo muaj, sic eshte kerkuar ne shtojcen 13 te Dokumentave te Tenderit.

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete shoqeri.

Te skualifikoje Operatorin Ekonomik “Gjoka Konstruksion” shpk pasi:

Nuk ploteson kerkesen 2.3.4 per kualifikim lidhur me stafin e angazhuar ne objekt, pasi: Inxhinieri Mihallaq Spirollari, i deklaruar si inxhinier ndertimi me profilin struktura, eshte i angazhuar ne objektin “Rikonstruksioni i infrastruktures se bllokut qe kufizohet nga rruga Endri Keko, Sadik Petrela dhe Lana”, me investitor Bashkia Tirane. Ne kete menyre edhe deklarata se stafi eshte i pa angazhuar ne objekte te tjere rezulton e pasakte.

Nuk ploteson kerkesen 2.3.8 per kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve dhe paisjeve, pasi:

1. Nga tre ekskavatore me goma te deklaruar, ne lejen e qarkullimit te ekskavatorit me targe AA227MC eshte shenuar se eshte “Per perdorim vetjak”. Referuar Ligjit 8378, date 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikes se shqiperise”, Pjesa II, Neni 81 “Destinacioni dhe perdorimi i mjeteve” pikat 1,2,3,4,5 dhe 7,8 percaktohet sa me poshte:

Me destinacion të mjetit nënkuptohet përdorimi i tij në bazë të karakteristikave teknike.

Me përdorim të mjetit nënkuptohet shfrytëzimi i tij ekonomik.

Mjetet mund të caktohen për përdorim vetjak ose për përdorim nga të tretët.

Quhet përdorim nga të tretët kur mjetet shfrytëzohen, kundrejt pagesës përkatëse, nga persona të tjerë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit. Për rastet e tjera nënkuptohet përdorimi vetjak i mjetit.

Përdorimi nga të tretët përfshin: a) dhënien me qira pa drejtues mjeti; b) dhënien me qira me drejtues mjeti dhe shërbimi taksi për transport njerëzish; c) shërbimin e linjës për transport pasagjerësh; d) shërbimin e transportit të mallrave për llogari të të treteve; e) shërbimin e linjës për transportin e mallrave; f) shërbimin taksi për transportin e mallrave për llogari të të treteve.

Pra sa më sipër ligjvënisi ka përcaktuar se në rastet kur mjeti jepet me qira në lejen e qarkullimit destinacioni i mjetit duhet të jetë e përcaktuar që mjeti të jepet për përdorim nga të tretët. Në të gjitha rastet e tjera mjeti është për përdorim vetjak dhe nuk mund të përdoret nga persona të tjerë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit kundrejt pagesës. Në të tilla raste ligjvënisi në pikën 8 përcakton sanksione sipas pikës 8 ku specifikisht citohet: “.....cilido që shfrytëzon një mjet me një destinacion ose për një përdorim të ndryshëm nga ato të treguara në lejen e transportit, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga pesë mijë deri në njëzet mijë lekë.”

Pra, bazuar në sa më sipër, rezultojnë se ky mjet është me destinacion përdorim vetjak dhe nuk mund të përdoret nga të tjerë pasi bie në kundërshtim me legjislativën në fuqi. Mjeti i mesiperm nuk mund të konsiderohet i rregullt nga komisioni i vlerësimit të ofertave. Ky arsyetim mbështetet edhe në Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr. 577 të vitit 2015, si dhe në Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr. 296 të vitit 2016.

2. Për të vertetuar disponimin e mjetit “Furçe mekanike për pastrim (fshese)” ka paraqitur një mjet tip atv me goma, por për këtë mjet nuk ka paraqitur lejen e qarkullimit, certifikatën e kontrollit teknik dhe vertetimin e pagesës për taksat vjetore në përputhje me kërkesën për kualifikim ku citohet: “Për mjetet vetelevizes që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojnë pronesinë e mjetit: - certifikatën e pronesisë; - leja e qarkullimit; - certifikatën e kontrollit teknik; vertetimin e pagesës për taksat vjetore; siguracionin dhe fotot përkatëse; ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerazë”.
3. Për të vertetuar disponimin e një prej dy mjeteve “Freze asfalti” ka paraqitur një mjet tip atv me goma, por për këtë mjet nuk ka paraqitur lejen e qarkullimit, certifikatën e kontrollit teknik dhe vertetimin e pagesës për taksat vjetore në përputhje me kërkesën për kualifikim ku citohet: “Për mjetet vetelevizes që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojnë pronesinë e mjetit: - certifikatën e pronesisë; - leja e qarkullimit; - certifikatën e kontrollit teknik; vertetimin e pagesës për taksat vjetore; siguracionin dhe fotot përkatëse; ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerazë”.
4. Për të vertetuar disponimin e një prej dy mjeteve “Mjet autovinc” ka paraqitur mjetin autovinc “Locatelli” por për këtë mjet nuk ka paraqitur lejen e qarkullimit, certifikatën e kontrollit teknik dhe vertetimin e pagesës për taksat vjetore në përputhje me kërkesën për kualifikim ku citohet: “Për mjetet vetelevizes që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojnë pronesinë e mjetit: - certifikatën e pronesisë; - leja e qarkullimit; - certifikatën e kontrollit teknik; vertetimin e pagesës për taksat vjetore; siguracionin dhe fotot

perkatëse; ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerese”.

5. Per te vertetuar disponimin e mjetit “Makineri per punime ne lartesi (makine kulle)” ka paraqitur mjetin tip apv me targe AA245NS, te marre me qera nga shoqeria “Pastrime Silvio” shpk. Ne lejen e qarkullimit te ketij mjeti eshte shenuar se eshte “Per perdorim vetjak”. Referuar Ligjit 8378, date 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikes se shqiperise”, Pjesa II, Neni 81 “Destinacioni dhe perdorimi i mjeteve” pikat 1,2,3,4,5 dhe 7,8 percaktohet sa me poshte:

Me destinacion të mjetit nënkuptohet përdorimi i tij në bazë të karakteristikave teknike.

Me përdorim të mjetit nënkuptohet shfrytëzimi i tij ekonomik.

Mjetet mund të caktohen për përdorim vetjak ose për përdorim nga të tretët.

Quhet përdorim nga të tretët kur mjetet shfrytëzohen, kundrejt pagesës përkatëse, nga persona të tjerë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit. Për rastet e tjera nënkuptohet përdorimi vetjak i mjetit.

Përdorimi nga të tretët përfshin: a) dhënien me qira pa drejtues mjeti; b) dhënien me qira me drejtues mjeti dhe shërbimi taksi për transport njerëzish; c) shërbimin e linjës për transport pasagjerësh; d) shërbimin e transportit të mallrave për llogari të të treteve; e) shërbimin e linjës për transportin e mallrave; f) shërbimin taksi për transportin e mallrave për llogari të të treteve.

Pra sa më sipër ligjvenesit ka percaktuar se ne rastet kur mjeti jepet me qera ne lejen e qarkullimit destinacioni i mjetit duhet te jete e percaktuar qe mjeti te jepet per perdorim nga të tretet. Në të gjitha rastet e tjera mjeti eshte per perdorim vetjak dhe nuk mund te perdoret nga persona të tjere te ndryshem nga titullari i lejes se qarkullimit kundrejt pageses. Në të tilla raste ligjvenesit ne piken 8 percakton sanksione sipas pikes 8 ku specifikisht citohet: “.....cilido që shfrytëzon një mjet me një destinacion ose për një përdorim të ndryshëm nga ato të treguara në lejen e transportit, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga pesë mijë deri në njëzet mijë lekë.”

Pra, bazuar ne sa me siper, rezulton se ky mjet eshte me destinacion perdorim vetjak dhe nuk mund te perdoret nga te trete pasi bie ne kundershtim me legjislacionin ne fuqi. Mjeti i mesiperm nuk mund te konsiderohet i rregullt nga komisioni i vleresimit te ofertave. Ky arsyetim mbeshetet edhe ne Vendimin e Komisionit te Prokurimit Publik nr. 577 te vitit 2015, si dhe ne Vendimin e Komisionit te Prokurimit Publik nr. 296 te vitit 2016.

Per te vertetuar disponimin e dy rrulave gome – hekur me kapacitet jo me pak se 18 ton ka paraqitur rrulin Dynpac CA 5000. Nga skeda teknike e ketij mjeti (e shkarkuar nga interneti) rezulton se kapaciteti i ketij rruli eshte 16700 kg, pra me i vogel se kapaciteti i kerkuar.

Per te vertetuar disponimin e dy rrulave hekur – hekur me kapacitet mbi 8 ton ka paraqitur rrulin Caterpillar CB434D. Nga skeda teknike e ketij mjeti (e shkarkuar nga interneti) rezulton se kapaciteti i ketij rruli eshte 7570 kg, pra me i vogel se kapaciteti i kerkuar.

Per te vertetuar disponimin e nje rruli asfalti gome – gome me kapacitet mbi 18 ton ka paraqitur rrulin Dynpac CP 1200. Nga skeda teknike e ketij mjeti (e shkarkuar nga interneti) rezulton se kapaciteti i ketij rruli eshte 12000 kg, pra me i vogel se kapaciteti i kerkuar.

Mjetet e meposhtem te deklaruar ne tender si te pa angazhuar:

Kamioni me targe AA667RH
Autoboti i ujit me targe AA897IK
Kamioni me vinc me targe TR 40 49 M
Kamioncina me targe AA403BH
Kamioncina me targe AA856LC
Kamioncina me targe TR7619T
Autobetoniera me targe TR8965N
Autopompe betoni me targe AA451CJ
Rruli Dynpac Ca602D
Ekskavatori me goma ABMT97

pas verifikimit ne Bashkine Tirane rezultoi se jane te angazhuar ne objektin “Rikonstruksioni i infrastruktures se bllokut qe kufizohet nga rruga Endri Keko, Sadik Petrela dhe Lana”, me investitor Bashkia Tirane. Ne kete menyre edhe deklarata se mjetet jane te pa angazhuara ne objekte te tjere rezulton e pasakte.

Shoqeria “Gjoka” shpk nuk ka paraqitur grafikun e detajuar te punimeve duke parashikuar vleren e plote te punimeve pa tvsh per cdo muaj, sic eshte kerkuar ne shtojcen 13 te Dokumentave te Tenderit.

Te skualifikoje Operatorin Ekonomik “Viante Konstruksion” shpk pasi:

Nuk ploteson kerkesen 2.2.1 per kualifikim lidhur me xhiron e realizuar ne tre vitet e fundit, pasi xhiro mesatare e deklaruar nga kjo shoqeri eshte 204.952.570 leke nga 283.251.000 leke qe duhet ta kete sipas kerkeses per kualifikim.

Duke qene se kjo e mete eshte thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete shoqeri.

Te skualifikoje Operatorin Ekonomik “GPG” shpk pasi:

Nuk ploteson kerkesen 2.3.7 per kualifikim lidhur me disponimin e pikave te nevojshme te licenses, pasi nuk disponon piken e kerkuar te licenses NS 15 D. Kjo shoqeri disponon piken e licenses NS 15 A e cila eshte e pamjaftueshme per volumin e puneve qe do te kryhen.

Shoqeria “GPG” shpk nuk ka paraqitur grafikun e detajuar te punimeve duke parashikuar vleren e plote te punimeve pa tvsh per cdo muaj, sic eshte kerkuar ne shtojcen 13 te Dokumentave te Tenderit.

Te skualifikoje Operatorin Ekonomik “Grand Konstruksion M” shpk pasi nuk ka paraqitur asnje dokumentacion per kualifikim.

Te skualifikoje Operatorin Ekonomik “Kajmaku” shpk pasi nuk ka paraqitur asnje dokumentacion per kualifikim.

Te skualifikoje Operatorin Ekonomik “Vellezerit Hysa” shpk pasi nuk ka paraqitur asnje dokumentacion per kualifikim.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin e Operatoreve Ekonomike **"Albstar" shpk** (80%) & **"Hastoci" shpk** (20%), perfaqesuar nga shoqeria **"Albstar" shpk**, me adrese: Zona Industriale, Patos, Fier, me NIPT J62903512W, se oferta e paraqitur, me vlerë **676,303,207 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e tre mijë e dyqind e shtatë)** lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. "Sami Frashëri", Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda afatit ligjor nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **04.09.2018**.

Per proceduren, ne daten 10.09.2018 paraqiti ankese bashkimi i Operatoreve Ekonomike "Victoria Invest" shpk (38%), "Victoria Invest international" shpk (41%) dhe "Al Asphalt" shpk (21%). Ankeses ju kthye pergjigje ne daten 11.09.2018 duke mos e pranuar ate. Ankime ne KPP nuk ka patur.